

**TEFË TOPALLI**  
**JOLANDA BIBAJ**

**PËRCAKTORËT E SHPREHUR ME MBIEMRA + PËREMRA,  
EMRA, NDAJFOLJE DHE TRAJTIMI I TYRE NË BOTIME  
TË NDRYSHME TË LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE NË  
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Që prej vitit 2016 e këndej, në arsimin parauniversitar është futur në kurrikulën bërthamë lënda e gjuhës shqipe e ndarë nga letërsia. Në vitet e mëparshme, këto dy lëndë ishin konceptuar si një e vetme, të integruara në një tekst të përbashkët. Në këtë formë konceptimi u pa se nuk trajtoheshin të plota asnjëra prej të dyjave. Komunikimi i përditshëm në punë a shoqëri, ai mediatik apo edhe përmes rrjeteve sociale, të cilat për hir të së vërtetës jo rrallëherë ndikojnë për një “shprishje” të normës gjuhësore e komunikative, solli nevojën e ndarjes së këtyre dy lëndëve dhe studimin më të hollësishëm të secilës prej tyre.

Si e tillë lënda e gjuhës shqipe u plotësua me njohuri nga fusha e morfologjisë, sintaksës dhe leksikologjisë, të para si nevojë për rifreskimin e njohurive gramatikore, duke qenë se nxënësit krijojnë një shkëputje të mirëfilltë nga arsimi i mesëm i ulët në fakultet, shkëputje e cila reflektohet edhe sot e kësaj dite në mangësitë që shfaqin studentët universitarë të fakulteteve të ndryshme shqiptare në formimin gjuhësor, në paraqitjen shkrimore të tezave, detyrave të ndryshme të kursit apo edhe në komunikimin me njëri-tjetrin.

Detyra që lindi para hartuesve të programeve dhe të teksteve të gjuhës shqipe konsistonte në rimarrjen e njohurive gramatikore të trajtuara në arsimin bazë dhe në zgjerimin e tyre në arsimin e mesëm të lartë. Gjithashtu programi i ri, në përputhje me kornizën kurrikulare, përcaktonte edhe kompetencat që duhej të përvehtësonte nxënësi:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.

- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme.
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.<sup>1</sup>

Përzgjedhja e librave përmes alartekstit u jep mundësi si autorëve të teksteve, ashtu edhe shtëpive të ndryshme botuese të paraqesin alternativat më të mira para nxënësve dhe mësuesve. Objekt të punimi tonë kemi alartekstet e lëndës së gjuhës shqipe, për arsimin e mesëm të lartë, përkatësisht të klasës së njëmbëdhjetë dhe konkretisht trajtimin e kategorive funksionale të përcaktorëve. Vërejmë se kjo kategori funksionale sintaksore, trajtuar më gjerësisht edhe në *Gramatikën* e Akademisë<sup>2</sup>, ashtu si edhe tekstet e arsimit të lartë në lëndën e sintaksës së gjuhës shqipe, del në mënyrë të përafërt, pa ndryshime themelore, si tek botimet e M. Domit<sup>3</sup>, M. Çelikut<sup>4</sup>, M. Totonit, të cilët janë bazuar fort edhe në punimet e traditës së kësaj fushe që nga Xhuvani<sup>5</sup>, Sheperi<sup>6</sup>, Rrota<sup>7</sup>, Cipo<sup>8</sup> etj., deri te gramatika e studiuesve të mëvonshëm<sup>9</sup> apo ajo e M. Camajit.

<sup>1</sup> Programi i lëndës së *Gjuhës shqipe*, klasa X, Tiranë, 2016, f. 2. Marrë nga interneti: izha.edu.al

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*, Tiranë, 2002, f. 221-239.

<sup>3</sup> M. Domi, *Sintaksa e gjuhës Shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1970, f. 20-23.

<sup>4</sup> M. Çeliku, *Sintaksë e Gjuhës Shqipe* (Përbërësit Sintaksorë), vështrim i ri teorik, shtëpia botuese Ilar, Tiranë, 2012, f. 197-212.

<sup>5</sup> A. Xhuvani, *Njohnit e Para të Syntaksës Shqipe*, Pjesë Parë, Për Klasat e Nalta të Fillores, Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë, 1933.

<sup>6</sup> I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe* (sidomos e toskënishtes), për shkollat të mesme, Vlorë, 1927, f. 142-144.

<sup>7</sup> J. Rrota, *Syntaksa e Gjuhës Shqipe*, për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, botim i dytë, Shpija botuese “A. Gj. Fishta”, Shkodër, 1944.

<sup>8</sup> K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, N.I.SH. Shtypshkronjave- Stab. Mihal duri, Tiranë, 1952.

<sup>9</sup> A. Kelmendi, M. Hasimja, *Gramatika e Gjuhës Shqipe* (Sintaksa), për klasën e II të arsimit të mesëm të orientuar, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1989.

Në trajtimin tonë do të vërejmë disa pika ku afrohen dhe ku nuk përkojnë prurjet teorike e praktike të 4 teksteve të shtëpive botuese<sup>10</sup> që gjenden dhe janë në përdorim në shkollat tona. Është e dukshme që këto altertekte kanë marrë si bazë pikënisjeje të analizës dhe shtjellimit të tyre *Gramatikën* e Akademisë. Në vijim do të shohim si i kanë trajtuar kategorinë e përcaktorëve këto shtëpi botuese.

➤ Kështu autorët e shtëpisë botuese “Albas” bëjnë këtë përkufizim të përcaktorit: “Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që varet zakonisht nga gjymtyrë të shprehura nga emra, me të cilat vihet në marrëdhënie përcaktore”. Dallohen:

Llojet e përcaktorëve	Lidhja me fjalën drejtuese	Shprehet me:	Shembuj
Me përshtatje	Përshtatet me gjymtyrën që përcakton	Mbiemër	<i>Kjo ishte një ngjarje e madhe. Ky ishte një projekt i madh.</i>
		Përemër	<i>Të gjithë këta të rinj dinë gjuhë të huaja.</i>
		Numëror	<i>Tri takimet nuk kishin qenë të suksesshme.</i>
Me drejtim	Shprehet me emër pa parafjalë:	Emër në rasën gjinore	<i>Ata po shiujonin fëshfërimën e gjetheve.</i>
		Emër në rasën rrjedhore	<i>U dëgjuan zhurma hapash.</i>
		Emër të pashquar në rasën kallëzore	<i>I pihej një gotë ujë</i>
	Emër ose përemër me parafjalë:	Në rasën rrjedhore	<i>Këta janë disa nga nxënësit. Cili nga ata do të vijë?</i>
		Në rasën kallëzore	<i>Malet me borë dukeshin që larg. Ky ishte takimi për fitoren.</i>

<sup>10</sup> *Gjuha shqipe 11*, për arsimin e mesëm të përgjithshëm, Botimet Pegi, Tiranë, maj, 2017.

*Gjuha shqipe 11*, për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, Shtëpia Botuese Mediaprint, Tiranë, botimi i parë 2017, ribotim i përmirësuar 2018.

*Çelësi i letërsisë dhe i gjuhës shqipe*, botimet Albas, Tiranë, 2019.

*Drejt Maturës, Gjuhës Shqipe dhe Letërsi, Koncepte, Ushtrime, Analiza, Komente, Teste*, Botimet Filara, Tiranë, 2018.

		Në rasën rrjedhore	<i>Kjo ishte një kullë prej guri. Pati shumë pyetje rreth provimeve.</i>
Me bashkim	Shprehet me po ato pjesë shënjuese të ligjëratës që nuk lakohen dhe nuk zgjedhohen	Përemra	<i>Ç'ditë e bukur qenka sot! Asnjë ditë nuk ishte si të tjerat.</i>
		Ndajfolje	<i>Shtëpia përballë ishte lyer me një ngjyrë rozë të thellë.</i>
		Numërorë	<i>Dhjetë ditët i ishin dukur shumë të gjata.</i>
		Forma foljore të pashtjelluara	<i>Shteg për të dalë nuk kishte ...</i>

**Ndajshtimi** është një lloj përcaktori që shprehet me emër a grup emëror në trajtë të pandryshueshme. Ai shprehet me:

○ Emër: **Profesor Çabej ka një kontribut të jashtëzakonshëm në studimet gjuhësore. Fjala “nënë” është fjala më e dashur për të gjithë. Me fytyrën flakë u kthye i zemëruar nga ai.**

○ Grup emëror: **Nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri” në Kosovë dallohen për rezultate të larta. Të gjithë e dimë fjalën e urtë “Qesh mirë kush qesh i fundit”<sup>11</sup>.**

○ Përemër: **Ne shqiptarët ndihemi shumë krenarë për historinë tonë.**<sup>12</sup>

➤ Një trajtim të ngjashëm paraqesin edhe autorët e shtëpisë botuese “Mediaprint”, të cilët rimarrin përkufizimin e përcaktorit si: Gjymtyrë e dytë e fjalisë që hyn në marrëdhënie përcaktore me gjymtyrën nga varet dhe që bashkohet me të me lidhje përshtatjeje, drejtimi a bashkimi, i cili varet nga një gjymtyrë e shprehur me emër, grup emëror, dhe përemër. Ndër të tjera, dallohen edhe lidhjet

<sup>11</sup> Në fakt kjo paraqet një fjali të mirëfilltë, në formën e një shprehjeje frazeologjike, si e tillë nuk mund të pranohet si një grup emëror. Nëse emërtimi do të ishte sintagmë në vend të grup emëror, do të ishte i pranueshëm, pasi sintagma është njësi e pakufizuar, nga një morfemë deri në fjali të plota si ajo e sipërcituar.

<sup>12</sup> Çelësi i letërsisë dhe i gjuhës shqipe, botimet Albas, Tiranë, 2019, f. 73.

sintaksore të përshtatjes, drejtimit dhe bashkimit. Këtu paraqiten edhe njetet e shprehjes së përcaktorit me përshtatje: me mbiemër, përemër dhe numërorët tre/tri, të dy, të tre etj. Ndërsa përcaktori me drejtim gjen shtjellim më të gjerë, ku veç shprehjes së tij me emër në rasën gjinore, rrjedhore e kallëzore me dhe pa parafjalë, jepet edhe emri si përcaktor i cili mund të tregojë:

- a) Cilësi: *Ana është vajzë **me mend**.*
- b) Përkatësi: *Në duart e rreshkura **të nënës** unë shikoja mundin e viteve të punës.*
- c) Lëndë: *Mbante në dorë një çantë **lëkure**.*
- d) Pronar: *Shtëpia e **gjyshes** ishte plot me njerëz.*
- e) Lloj (karakteristikë): *Ishte qetësi dhe nuk pipëtinte zë **njeriu**.*
- f) Origjinë: *Ullinj të **e Beratit** nuk mungojnë në tryezat tona.*
- g) Destinacion: *Në dorë mbante ushqim për fëmijë. Në qytetin tim ndodhet një shtëpi **pushimi**.*

Kurse përcaktori me bashkim shprehet me përemra të palakueshëm, me numërorë, me forma foljore të pashtjelluara dhe me ndajfolje, dhe secili prej tyre ilustron me shembuj: *Në qendrën e fshatit ishin mbledhur **shumë** njerëz. **Të katër** motrat prisnin me padurim ardhjen e vëllait të tyre. Dëshira **për të kënduar** më ka lindur që fëmijë. **Qilimat punuar me dorë** u pëlqyen më shumë nga turistët. Klasa **përballë** është kabineti i fizikës.*

Edhe te ky botim ndajshtimi merret si një ndër llojet e përcaktorëve, të shprehur me emër të pashquar, që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar. Përshtatja jo e plotë e dallon ndajshtrimin si një lloj përcaktori të veçantë. Përsëri këtu ka një trajtim më të plotë të tij, duke përcaktuar edhe marrëdhënien e ndajshtrimit me emrin nga i cili varet dhe pozicionin e tij, para dhe pas emrit që përcakton. Kur ndajshtimi ndodhet para fjalës që përcakton, tregon:

a) Marrëdhënie farefisnore: ***Gjyshe** Vera i tregon bukur përrallat. **Xhaxhi** Agroni ka projektuar qendrën tregtare të qytetit tonë.*

b) Profesione, detyrë, titull: *U takuam në rrugë me **mësuese** Mirën. **Murator** Beni është usta i mirë. Libri i **profesor** Yllit flet për sëmundjet e zemrës.*

Kur ndajshtimi ndodhet pas fjalës që përcakton, tregon:

- a) Cilësi ose lloj: *O flamur **gjak**, o flamur **shkabë**...*

b) Emër vendi gjeografik, vepër letrare, gazetë, institucion: *Deti Jon është në qytetin e Sarandës. Komedia “Shi në plazh” më pëlqen shumë.*<sup>13</sup>

➤ Autorët e shtëpisë botuese “Filara” bëjnë një trajtim të ngjashëm me atë të dy botimeve të tjera për sa i përket vështrimit të përcaktorëve, por ndalen pak më shumë tek ndajshtimi, ku dallojnë dy llojet e tij, të veçuar/të paveçuar, ndërsa bëjnë edhe sqarimet përkatëse:

- Ndajshtimi i veçuar jep të dhëna plotësuese; jep në mënyrë të spikatur një karakteristikë të një personi a sendi; sqaron ose saktëson kuptimin e gjymtyrës që përcakton. Meqë lidhja me gjymtyrën e përcaktuar është e dobët, ndajshtimi i veçuar ndahet prej saj me pauzë e shqiptohet me ton të ulët. Ai mund të jetë i pazgjeruar ose i zgjeruar dhe qëndron para emrit të përcaktuar ose pas tij. Ndajshtimi që qëndron pas emrit të përcaktuar është një emër i përveçëm njeriu, sendi, kafshe, muaji, etj., ose mund të jetë grup emëror. Disa ndajshtime që qëndrojnë prapa emrit të përcaktuar, mund të shprehen jo vetëm me emër, por edhe me grup emëror dhe nuk përshtaten në numër me emrin e përcaktuar. Ndajshtime të tilla janë: emërtimet e gazetave, revistave, të veprave letrare, të rrugëve, të institucioneve të ndryshme etj. Një vend të veçantë zë ndajshtimi pas fjalëve të tilla si: fjalë, shprehje, koncept etj. Ky ndajshtim vihet midis thonjëzave, por nuk shkruhet me shkronjë të madhe.

Nga ana tjetër edhe përcaktorët kanë një paraqitje më komplekse e në përshtatje me njohuritë që duhet të nxërë maturanti. Kështu, sipas këtij botimi, përcaktorët mund të tregojnë:

- i. Karakteristikë ose cilësi që perceptohet me anë të shqisave: *çarçafë të bardhë, rrugë e ngushtë, shkollë e madhe, supë e nxehtë* etj.

- ii. Cilësi të karakterit ose të zhvillimit mendor: *fëmijë i zgjuar, burrë i besës, njeri i matur* etj.

---

<sup>13</sup> *Gjuha shqipe 11*, për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, Shtëpia Botuese Mediaprint, Tiranë, botimi i parë 2017, ribotim i përmirësuar 2018, f. 109-111.

iii. Lëndë: *fustan mëndafshi, tavolinë e drunjtë, çantë lëkure, kasolle prej kashte* etj.

iv. Objekt: *mbyllja e dyqaneve, restaurimi i pallatit* etj.

v. Përkitje ose pronësi: *vëllai im, qyteti ynë, dhomat e sportistëve* etj.

vi. Vend: *ndërtesa përballë*.

Ndër të tjera jepen edhe disa veçori të përcaktorëve, si:

✓ Përshtatja në numër, gjini dhe në rasë me emrin që përcaktojnë, kur shprehen me mbiemra të nyjshëm;

✓ Pozicioni i tyre - pas fjalës së përcaktuar: *Rrezet e fundit të diellit binin mbi plugjet*. me raste edhe para fjalës së përcaktuar: *Në mbrëmje pushonte zhurma e motorëve dhe shtatë mijë punëtorët linin punën*.

✓ Prania e më shumë se një përcaktori: një gjymtyrë mund të marrë më shumë se një përcaktor, të cilët nuk ndahen me presje dhe as me anë të lidhëzave bashkërenditëse.<sup>14</sup>

➤ Edhe autorët e shtëpisë botuese “Pegi” kanë një trajtim të ngjashëm duke dhënë përkufizimin klasik të përcaktorit. Aty është shtuar që përcaktori mund të hyjë në lidhje me një kryefjalë, kundrinor apo rrethanor, por jo me kallëzuesin. Sipas këtij teksti, përcaktorët janë pjesë e pandashme e grupeve të fjalëve që lidhen me foljen dhe zhvendosen bashkë me fjalët e tyre drejtuese në fjali. Sado të zgjerohet grupi i kryefjalës, kundrinorit apo rrethanorit, fjalët e varura prej tyre nuk hyjnë në lidhje të drejtpërdrejtë me kallëzuesin, por mbeten të lidhura ngushtë me fjalët drejtuese përkatëse. Ato mund të zhvendosen vetëm si grupe në fjali. Edhe këtu dallohet fjala drejtuese e përcaktorëve që mund të jetë:

○ Një emër që shërben si kryefjalë, kundrinor, rrethanor: *Shkolla e re u ndërtua sivjet. Të gjithë do të donin një shkollë të re. Fëmijët loznin para shkollës së re*.

○ Përemër që shërben si kryefjalë, kundrinor: *Sytë më zunë diçka të pazakontë*.

Ashtu si në trajtimet e teksteve të lartpërmendura, edhe në këtë tekst shkollor jepen llojet e përcaktorëve dhe mjetet e tyre të shprehjes:

---

<sup>14</sup> *Drejt Maturës, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Koncepte, Ushtrime, Analiza, Komente, Teste*, Botimet Filara, Tiranë, 2018, f. 55-57.

Llojet e përcaktorëve	Lidhja me fjalën drejtuese	Shprehet me:	Shembuj
Me përshtatje	Fjala drejtuese e drejton në gjini, numër dhe rasë	Mbiemër	<i>Fletore e hapur</i>
		Përemër	<i>Secilën fletore</i>
		Numëror	<i>Tri fletore</i>
Me drejtim	Fjala drejtuese e drejton në rasë	Emër në rasën gjinore	Gota e <b>ujit</b>
		Emër në rasën rrjedhore	<i>Gotë uji</i>
		Emër në rasën kallëzore	<i>(një) gotë ujë</i>
Me bashkim	Fjala drejtuese nuk e kushtëzon formën e fjalës së varur	Fjalë të pandryshueshme: përemra	<b>Gjithë njerëzit</b>
		ndajfolje	<i>Kodra përbri</i>
		Forma foljore të pashtjelluara	<i>Dëshira për të mësuar</i>

Ndajshtimi shihet si lloj i veçantë përcaktori i cili shprehet me emër të pashquar dhe përshtatet në numër me fjalën drejtuese: *Nënë Tereza i donte të gjithë njerëzit. Lumi Vjosë ka një bukuri përrallore.*<sup>15</sup>

Tekstet e arsimit të mesëm të lartë synojnë të formojnë nxënësin si nga ana gjuhësore, ashtu edhe kulturore. Si të tilla duhet t'i mësojnë më fort sintaksën së komunikimit, si një formë njësimi kulturor i krejt brezit të 16-18 vjeçarëve, me qëllim që të shmangen shformime të komunikimit të tipit “që kështu”, në vend të “kështu që” apo edhe të pajisjes me njohuritë bërthamë të gramatikës. Kjo ngulitje nuk u shërben thjesht për përgatitjen për testin e maturës, që për hir të së vërtetës, në vitin 2019 dëshmoi një nxënie të dobët të njohurive morfo-sintaksore<sup>16</sup>, por edhe për formimin e identitetit të tyre kulturor e gjuhësor në përgjithësi.

Kështu nga trajtesa e mësipërme, u vunë re ngjashmëri në të katër altertekstet në lidhje me llojet e përcaktorëve, si dhe

<sup>15</sup> *Gjuha shqipe 11*, për arsimin e mesëm të përgjithshëm, grup autorësh, Botimet Pegi, Tiranë, maj 2017, f. 148-150.

<sup>16</sup> Në vitin 2019 provimi i maturës në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, kishte në përmbajtjen e tij edhe një fragment me pyetje për gramatikën dhe njohuritë gramatikore që nxënësit e arsimit të mesëm të lartë kanë nxënë gjatë tri viteve. Pas përfundimit të vlerësimit të testeve, u vu re që nxënësit maturantët kishin mangësi të dukshme në formimin morfo-sintaksor dhe mesatarja e përgjithshme e testit të maturës ishte 6.

përkufizimin e tyre. Mund të thuhet pra, që nxënësi e mësoi ç'është përcaktori, por nuk ka një trajtim të mjaftueshëm, shpesh është i cekët dhe pa depërtim në strukturat e thjeshta e aq më pak në ato të ndërlikuarat. Autorët e shtëpisë botuese "Pegi" bënin dallimin që përcaktonte zhvendosjen e përcaktorëve si grupe fjalësh e që nuk lidheshin me kallëzuesin. Pra, sipas kësaj shtëpie botuese nuk mund të ketë përcaktor me bashkim që ka si pjesë të tij një kallëzues, kur në fakt ka studiues si R. Memushaj që e dallon si një ndër llojet e përcaktorëve me bashkim edhe pranëvënien e një foljeje me një ndajfolje, si në rastin: *flet shpejt, ecën ngadalë* etj.<sup>17</sup> Sipas teorisë që paraqet studiuesi në fjalë, përcaktorët përfshihen në kategorinë e modifikuesve, të cilët kuptohen si përbërës sintagmatikë që lidhen me emrin dhe kanë funksion kufizues ndaj kokës leksikore.<sup>18</sup> Ndërsa në një studim tjetër vërehet një përkufizim i tillë: "Përbërësi sintaksor në funksion të përcaktorit shoqëron në lidhje varësie një përbërës emëror kokë. Me fjalë të tjera, përcaktori është zgjerim i një përbërësi emëror kokë. Ky përbërës mund të shprehet me një emër të shquar a me një emër të pashquar të paraprirë nga caktuesorë të ndryshëm, por që në çdo rast funksionon si gjymtyrë fjalie (kryefjalë, kundrinor, rrethanor etj.). Përcaktori bashkë me përbërësin emëror nga i cili varet ndërton një përbërës të zërthyeshëm në dy përbërës të tjerë, ku secili është gjymtyrë më vete."<sup>19</sup>

Studiuesi M. Çeliku pohon se përcaktorët shoqërojnë emrat duke kufizuar kuptimin e tyre leksikor. Një trajtim në vijim të traditës së studimeve sintaksore paraqet edhe M. Domi, i cili përcaktorët i emërton cilësorë që vijnë si pasojë e zgjerimit të gjymtyrës me fjalë plotësuese, ngarkesën e një gjymtyre edhe me shprehjen e ndonjë raporti tjetër, përveç atij të zakonshmit etj.<sup>20</sup> Ndërsa një tjetër studiues i traditës, Sheperi, përcaktorët i emërton *kallëzues – atribut*, duke dalluar se cilat kategori mund të marrin një funksion të tillë, ku mes tyre përmend: mbiemrat, emrat dhe çdo pjesë të ligjëratës që mund të

<sup>17</sup> R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë, 2006, f. 246.

<sup>18</sup> Po ai, *po aty*, f. 248.

<sup>19</sup> M. Çeliku, *Sintaksë e Gjuhës Shqipe* (Përbërësit sintaksorë. Vështrim i ri teorik), ILAR, Tiranë, 2012, f. 197.

<sup>20</sup> M. Domi, *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 19.

përdoret si mbiemër, rasa gjëndore (gjinore), numërorët dhe fjali të tëra.<sup>21</sup>

Studiuesi italian Graffi, teksa analizon këto dukuri në italishte, i përfshin në klasën e përcaktuesve fjalë si: *questo, quello, il* etj., duke i ndarë pastaj në dy nënklasa të tjera: atë të përcaktorëve që nuk mund të përdoren pa emrin (nyjat shquese dhe joshquese) dhe atë të përcaktorëve që përdoren veçmas (*questo, quello* etj).<sup>22</sup>

Jemi të mendimit që futja dhe përdorimi i konceptit të sintagmës nuk është i parakohshëm edhe në tekstet shkollore të gjimnazit, duke qenë se është njësi sintaksore me madhësi të pakufizuar.

Në lidhje me trajtimin e përcaktorëve, mendojmë se u duhet lënë një hapësirë më e madhe jo vetëm strukturave të thjeshta, por edhe atyre të përbëra, si p.sh.: *djali i motrës sime*, ku mund të dallohen dy përcaktorë të ndryshëm, thënë ndryshe një sintagmë dypërbërese:

1. *djali i motrës* – përcaktor me drejtim i shprehur me emër në rasën gjinore (E<sub>2</sub>)

2. *motrës sime* – përcaktor më përshtatje i shprehur me përemër pronor.

Në këtë rast, duhet sqaruar që lidhja fillimisht bëhet me përcaktorin e parë, kjo lidhje nuk është e mundur të bëhet më të dytin, krahaso:

\**djali sime*.

Në vijim do të propozojmë disa shembuj sintagmash dy, tre ose katërpërbërese përcaktorësh dhe mundësitë e analizës së tyre sipas teorisë X-bar<sup>23</sup>, që shtjellon gjenerimin e tyre dhe njëkohësisht lidhjet

<sup>21</sup> I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe* sidomos e toskënishtes (për shkolla të mesme), Vlorë, 1927, f. 142.

<sup>22</sup> G. Graffi, *Sintaksa, Strukturat e ligjëritimit*, përkthyer në shqip nga Dr. Blerta Topalli, Dituria, 2003, f. 53.

<sup>23</sup> Kjo teori përcakton më së miri strukturën e sintagmave. Elementet e saj janë:

$X^0$  = koka

$X'$  = projektioni i ndërmjetëm, i përbërë nga një kokë  $X^0$  dhe një komplement XP = projektioni maksimal, që është i përbërë nga një projektion i ndërmjetëm  $X'$  dhe një specifikes  $X^0$ . Rendi i këtyre elementeve është:


$X'$  dominon  $X^0$  dhe komplementin e tij,

XP dominon  $X'$  dhe specifikesin e  $X^0$

sintaksore të përcaktorëve. Kjo teori, që gjen shtjellimin e saj më herët tek Tesnieri<sup>24</sup>, bën të mundur paraqitjen skematike të raporteve hierarkike nga e cila varet kuptimi i frazës.

Gjenerimi i sintagmës dypërbërëse: *djali i motrës sime*, do të paraqitetj në këtë mënyrë:

1) Djali i motrës (përcaktor me drejtim)



Shembulli i kësaj sintagme<sup>25</sup> paraqet gjenerimin tipik të një përcaktori me drejtim të shprehur me emër në rasën gjinore, me të dy emrat e shquar, me nyjen e pasme të trupëzuar me emrin. Duke qenë

X<sup>0</sup> përfaqëson një nga kategoritë leksikore: emër, folje, mbiemër, parafjalë. Për më tepër shih: G. Turano, *Dipendenze sintattiche in albanese*, Unipress, Padova, 1995, f. 16.

<sup>24</sup> Tesnieri fut grafikata e quajtura stema, që zhvillohen në mënyrë vertikale, në të cilën fjalët nuk dalin në rendin e tyre, por janë të vendosura sipas pozicionit që zënë në hierarkinë e frazës, duke formuar grupime të ndërmjetme nyjash. Folja e shtjelluar është konsideruar nyja qendrore e frazës, d.m.th. elementi që zë pozicionin më të lartë në frazë. Për më shumë shih: Ch. De Santis, *Che cos'è la grammatica valenziale*, Carrocci editore Bussola, Roma, 2016, f. 22.

<sup>25</sup> R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2003, f. 100. Të shihet edhe A. Kananaj, *Rrethanori në gjuhën shqipe*, monografi, Tiranë, 2015, f. 36.

se para emrit *motrës* ndodhet nyja e gjinore, atëherë kjo nyje gjenerohet më lart se nyja e pasme e emrit, kurse emri lë pozicionin e tij për t'u bashkuar me nyjen e pasme.<sup>26</sup>

Na mbetet të argumentojmë pozicionin e sintagmës së dytë: *motrës sime*, që përbëhet nga një emër i shquar dhe një përemër pronor. Në lidhje me strukturën e brendshme të përemrave pronorë, vihet re që, në shqipe, ata sillen si mbiemrat, d.m.th. rrinë pas emrave, me veçori specifike të cilat i lejojnë përemrat pronorë të lidhjes farefisnore të pozicionohen edhe para emrit, krahasojmë: *motrës sime – sime motre*. Por në këtë pozicion mund të rrinë vetëm pronorët e vetës së parë dhe të dytë njëjës, të vetës së tretë nuk është e mundur dhe as vetat e shumësit. Krahasojmë p.sh.: \*i tij djalë/juaj motër/e saj bijë/ tanët vëllezër etj.

Një analizë të përimët të mbiemrave në pozicion paraemëror i ka bërë shqipes A. Adrouspolou e cila pohon se kur mbiemri ndodhet para emrit, ai ngrihet në pozicionin e Spec të AgrP, kurse në rastet kur mbiemri e ndjek emrin, është emri ai që ngrihet në këtë pozicion për të marrë rasë dhe shquarsi.<sup>27</sup>

Në rastet kur pronori ndodhet në vendin e tij natyral, d.m.th. pas emrit, emri përpara shoqërohet gjithmonë me nyjen shquese të trupëzuar me të. Kjo shpjegon edhe llojin e përcaktorit me përshtatje, quhet i tillë sepse përshtatet në gjini dhe numër me emrin që ka përpara. Gjenerimi i sintagmës *motrës sime* do të ishte:


## 2) *Motrës*<sup>28</sup> *sime* (përcaktor me përshtatje)

<sup>26</sup> Për më tepër shih: F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shblu, Tiranë, 2011, f. 63-73.

<sup>27</sup> A. Adrouspoulou, *Adjectival determiners in Albanian and Greek*, në *Comparative Syntax of Balkan Languages*, Oxford University Press, 2001, f. 177-178.


<sup>28</sup> “Nyjet e pashquara qëndrojnë e paraqitin njerinë a sendin si një midis shumë të tjerësh. Nyjet shquese e rrëfejnë njerinë si një që dihet se kush është.” K. Cipo, *Sintaksa*, N.I.Sh Shtypshkronjave – Stab. Mihal Duri, Tiranë, 1952, f. 22.

Përcaktorët e shprehur me mbiemra + përemra, emra ...



Në klasën e determinantëve futen, siç dihet, nyjat e parme të emrave dhe ato të fundoret, nyjat e mbiemrave, përemrat pronorë, dëftorë, pyetës dhe të pacaktuar.<sup>29</sup>


3) *Fëmijë i zgjuar* (përcaktor me përshtatje)



Duke qenë se mbiemri është i nyjshëm, kjo sintagmë nuk gjenerohet si sintagmë mbiemërore, por si një sintagmë determinante.

4) *Libër interesant* (përcaktor me përshtatje, ndër tipat më të zakonshëm të përcaktorëve me përshtatje të shprehur me mbiemër, në pozicion pas emrit)

<sup>29</sup> F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shblu, Tiranë, 2011, f. 65.




Kuptimi i konceptit “përbërës” lidhet me konceptin “i pandashëm”, sepse fjala e fundit në modelin: “*në javën e fundit të korrikut*” – emri del në  $E_2$  nuk gjymtyrëzohet, pasi i mungon lidhja gramatikore me emrin *javën* dhe *të korrikut*, kështu që nuk funksionon si përcaktor, por është fjalë përcaktuese dhe lidhet me sintagmën “*në javën*”, e cila duke qenë trajtë e shquar  $E_4$  dhe e prirë nga para fjala e kësaj rase të zhdrejtë, nuk mund të qëndrojë më vete si gjymtyrë funksionale. Rasa morfologjike është realizimi i gjurmës sintaksore të Rasës (me shkronjë të madhe) dhe thuhet edhe Rasë abstrakte, sepse nuk realizohet gjithmonë morfologjikisht, tipar të cilin e kanë të gjitha sintagmat emërore në të gjitha gjuhët. Gjurma e Rasës përcakton shpërndarjen sintaksore të SE, duke kërkuar që të hyjnë në marrëdhënie me një element që quhet “caktues” Rase. Dallohen Rasat inherente (gjinorja, dhanorja), të kërkuara nga koka caktuese dhe Rasat strukturore (emërorja, kallzorja) që varen nga struktura sintaksore së cilës i referohet SE.<sup>30</sup> Në shqipe, studiuesja L. Buxheli dallon si rasa inherente rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore. Sipas saj caktimi i këtyre rasave kushtëzohet në planin sintaksor nga lidhja strukturore e caktuesit rasor me SE të varur. Kjo kërkon plotësimin e kushtit të lidhjes strukturore të drejtimit brenda konfiguracioneve të caktuara, të cilat janë dy llojesh: specifikes-kokë dhe kokë-plotësor.<sup>31</sup>


<sup>30</sup> A. Cardinaletti, *Esercizi di Sintassi*, Carocci editore, Roma, botimi i parë shtator 2009, botim i dytë maj 2015, f. 88.

<sup>31</sup> L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Botimet Neraida, Tiranë, 2007, f. 227.

5) Në javën e fundit të korrikut




6) Lulet e para të pranverës




Edhe nga ky shembull kuptohet se përbërësi i drejtpërdrejtë është sintagma: *lulet e para*, kurse E<sub>2</sub> të pranverës shërben si plotës SE dhe nuk kryen funksionin e përcaktorit, por të fjalës përcaktuese.

7) *Shpatin e veshur të malit* (sintagmë njëpërbërëse)



8) *Fjalët e dashura të mësuesit* (përcaktor me përshtatje, i shprehur me E<sub>1</sub> në trajtën e shquar, shumës + fjalë përcaktuese në E<sub>2</sub>)



Vihet re se E<sub>2</sub> – të mësuesit, funksionon si plotës i SD – fjalët e dashura.


Mirë do të ishte që në tekstet e arsimit të mesëm të lartë të trajtoheshin edhe rastet e përcaktorëve me rasi të zhdrejta, si p.sh.:

Përcaktorët e shprehur me mbiemra + përemra, emra ...


- a) *shoqen e mirë të punës,*
- b) *nxënësin tënd të dalluar,*
- c) *motrës sime të madhe etj.*

të cilat integrohen në sintagmat njëpërbërëse, por me një përcaktor dhe një fjalë përcaktuese. Në këta shembuj dallohen përcaktorët me përshtatje (të shprehur me mbiemra(a), përemra pronorë (b, c) si dhe fjalët përcaktuese E<sub>2</sub> (a), mbiemra (b, c).


9) *shoqen e mirë të punës* (përcaktor me përshtatje, i shprehur me kokë emrin në E<sub>4</sub> dhe me fjalë përcaktuese në E<sub>2</sub>)



10) *vatrën e paharruar të prindërve* – sintagmë njëpërbërëse me kokë emrin E<sub>4</sub> dhe me fjalë përcaktuese E<sub>2</sub>. Edhe në këtë shembull, vihet re se lidhja mes E<sub>4</sub> dhe përcaktorit është e fortë, kurse emri tjetër në E<sub>2</sub> shërben si plotës i kësaj sintagme, jo si përcaktor.



11) *Dëshira për të mësuar*<sup>32</sup> (përcaktor me bashkim, i shprehur me formë të pashtjelluar foljore<sup>33</sup>)



Një paraqitje e tillë skematike mund të duket e vështirë për klasat e arsimit të mesëm, por mendojmë se e njeh nxënësin paraprakisht me konceptin e sintagmës dhe të strukturës së shprehjes / thënies. Çdo nxënës e kupton<sup>34</sup> që fillimisht lidhjet realizohen mes: *djali i motrës*, më pas realizohet lidhja e dytë: *motrës sime*. Kështu ai njihet edhe me konceptin e drejtimit: është nyja që e drejton emrin në rasën gjinore<sup>35</sup>, por edhe me llojet e përcaktorëve me drejtim, ku

<sup>32</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe 1* i trajton këto folje si forma foljore të pashtjelluara duke qenë se nuk kanë kategorinë e kohës, mënyrës etj., d.m.th. nuk shtjellohen. Kjo formë paskajore përdoret me funksion qëllimor, përcaktor, përcaktori kallëzuesor të kryefjalës etj. Shih më gjerësisht: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 337-342.

<sup>33</sup> Kurse K. Cipo njeht dy kohë të infinitit: të tanishmen – (për të) këputur dhe perfektin (për të) pasë këputur. K. Cipo, *Gramatika Shqipe*, Instituti i Shkencave, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1949, f. 137.

<sup>34</sup> Lidhet me parimin e njohur çomskian të gramatikës së brendshme (internal language- që ka të bëjë me aftësinë e kombinimit të fjalëve në fraza) dhe (external language – që ka të bëjë me tërësinë e frazave të realizuara në një gjuhë të caktuar) F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipërisë*, Shblu, Tiranë, 2011, f. 16.

<sup>35</sup> Shiko për më shumë: R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 245-246. Këtu autori shpreh: “Kur fjala përcaktuese vihet në rasën që e kërkon koka e sintagmës, kemi lidhje me drejtim, p.sh. folja e do kundrinën e drejtë në rasën kallëzore dhe të zhdrejtën në rasën dhanore: *takoj shokun, ia dhashë shokut*; emri i përcaktuar e do emrin përcaktues në gjinore ose në rrjedhore: *buka e grurit* (gjinore), *bukë gruri* (dhanore); parafrasa e cila del

prezantohet me konceptin e parafjalës si kokë e sintagmës që drejton emrin në rasën e caktuar.

### **Përfundime**

• Mendojmë se do të ishte mirë që nocioni dhe trajtimi i përcaktorëve të ishte më i zgjeruar, i krejt llojeve të tyre. Përveç përcaktorëve, të shpjegohen edhe fjalët përcaktuese, të cilat shoqërojnë përcaktorët, por nuk quhen përcaktorë të mirëfilltë.

• Propozojmë të futet koncepti i sintagmës si term me të cilin operon gjuhësia botërore sot dhe që shpjegon më mirë lidhjet dhe marrëdhëniet mes njërive që ndjekin njëra-tjetrën në rrjedhën e ligjërit. Ky nocion përfshin njësitë e vogla si morfema (gj-u-h-ë), fjala (*gjuhë*), grupi i fjalëve (*gjuha shqipe*) ose fjalia (*Lënda e gjuhës studiohet në arsimin e mesëm të lartë*).

• Të “preket” teoria X-bar që ilustron lidhjet dhe hierarkinë e elementeve sintagmatike, konkretisht kategorinë funksionale të përcaktorëve me përshtatje, drejtim apo bashkim.

### **BIBLIOGRAFI**

- A. Androusoy, *Adjectival Determiners in Albanian and Greek*, në *Comparative Syntax of Balkan Languages*, Oxford University Press, 2001.
- A. Cardinaletti, *Esercizi di Sintassi*, Carocci editore, Roma, botimi i parë shtator, 2009, botim i dytë, maj, 2015.
- A. Kananaj, *Rrethanori në gjuhën shqipe*, monografi, Tiranë, 2015.
- A. Kelmendi, M. Hasimja, *Gramatika e gjuhës shqipe (Sintaksa), për klasën e II të arsimit të mesëm të orientuar*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1989.
- A. Xhuvani, *Njohnit e para të syntaksës shqipe, Pjes 'e Parë, Për Klasat e Nalta të Filllores*, Shtypshkronja “Teknike”, Tiranë, 1933.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2002.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002.
- Çelësi i letërsisë dhe i gjuhës shqipe*, botimet Albas, Tiranë, 2019.

---

gjithmonë si kokë e sintagmës, drejton rasën e emrit: *nga shtëpia* (emërore), *prej shtëpisë* (rrjedhore), *në shtëpi* (kallëzore)”

- Ch. De Santis, *Che cos'è la grammatica valenziale*, Carrocci editore Bussole, Roma, 2016.
- Drejt maturës, gjuhë shqipe dhe letërsi, koncepte, ushtrime, analiza, komente, teste*, Botimet Filara, Tiranë, 2018.
- F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shblu, Tiranë, 2011.
- G. Graffi, *Sintaksa, strukturat e ligjëritimit*, përkthyer në shqip nga Dr. Blerta Topalli, Dituria, 2003.
- G. Turano, *Dipendenze sintattiche in albanese*, Unipress, Padova, 1995.
- Gjuha shqipe 11*, për arsimin e mesëm të përgjithshëm, grup autorësh, Botimet Pegi, Tiranë, maj 2017.
- Gjuha shqipe 11*, për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, Shtëpia Botuese Mediaprint, Tiranë, botimi i parë 2017, ribotimi i përmirësuar 2018.
- I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes* (për shkollat të mesme), Vlorë, 1927.
- J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005.
- J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, botim i dytë, Shpija botuese “A. Gj. Fishta”, Shkodër, 1944.
- K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Instituti i Shkencave, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve dhe e Shpërndarjes, Tiranë, 1949.
- K. Cipo, *Sintaksa*, N.I.Sh Shtypshkronjave – Stab. Mihal Duri, Tiranë, 1952.
- L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Botimet Neraida, Tiranë, 2007.
- M. Çeliku, *Sintaksë e Gjuhës Shqipe* (Përbërësit sintaksorë. Vështrim i ri teorik), Ilar, Tiranë, 2012.
- M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971.
- Programi i lëndës së Gjuhës shqipe, klasa X, Tiranë, 2016, f. 2. Marrë nga interneti: [izha.edu.al](http://izha.edu.al)
- R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2003.
- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006.